



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHË  
KËSHILLI BASHKIAK

Librazhd më: 24.11.2023

**NJOFTIM**

**“PËR MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË”**

Z.znj. \_\_\_\_\_

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 53 pika 2 dhe pika 4, ju njoftojmë se ditën e **Enjte, datë 30.11.2023**, ora 10:00 do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak për muajin **Nëntor** 2023. Mbledhja do të zhvillohet te Salla e Këshillit në Bashki, me këtë rend dite:

1. P/Vendim “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha Tetor 2023”.
2. P/Vendim “ Për rritje e pakësim plani buxhetor të vitit 2023 të të ardhurave vendore”.
3. P/Vendim “ Për miratimin e paketës fiskale (taksave dhe tarifave vendore) në Bashkinë Librazhd për vitin 2024”.
4. P/Vendim “ Për miratimin e planit të integritetit 2024-2026”.
5. P/Vendim “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi”.
6. P/Vendim “ Mbi miratimin e Kryetarit të fshatit Hotolisht Z.Mahmud Çota njësia Administrative Hotolisht Bashkia Librazhd”.
7. P/Vendim “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet e strehimit ”.
8. P/Vendim “Për emërtimin e shkollës 9-vjeçare Zdrajshë –Qendër “Shejnaze Juka”.
9. P/Vendim “Miratimi i Planit të Aktiviteteve ,Konsultimeve dhe buxhetit të KB Librazhd për vitin 2024”.
10. Të ndryshme;

- Diskutimi me rininë për edukimin dhe punësimin e të rinjve.
- Ditën e Enjte datë 30.11.2023 ora 09:00 të mblidhet Komisionet te Salla e Këshillit.

KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BIÇAKU



P/Vendimi N° 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHID  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Adresa : Sheshi "Gjorg Golemi" Nr.Tël 0514 / 2352, e-mail:info@bashkialibrazhd.gov.al

**PROJEKT/VENDIM**

Nr. \_\_\_ Datë \_\_\_\_\_ 2023

**PROPOZIM MBI DHENIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR 6%  
FAMILJEVE TE REKOMANDUARA NGA SISTEMI ELEKTRONIK**

**PERIUDHA TETOR 2023**

Mbështetur në Ligjin nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave,të dokumentacionit dhe të masës mujore të ndihmës ekonomike,përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike"kreu IV ,Vendimit nr 956 datë 07.12.2016"Për përcaktimin e kritereve dhe detajeve të formules se unifikuar të pikezimit për përfitimin e ndihmës ekonomike"Sektori i Ndhmës Ekonomike pranë Drejtorise se Sherbimeve Sociale,nisur nga referimi në sistemin elektronik për familjet përfituese,si dhe nga propozimet dhe verifikimet social-ekonomike që janë bere nga Administratorët Shoqërore në Njesitë Administrative,bazuar në kompetencat që na jep ligji propozojmë:

**VENDOSI :**

1. Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuar 6% , 89 familje me një fond 378,703 lekë të rekomanduar në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike, për arsye të mos plotësimit të pikëve por që në bazë projekt propozimeve dhe verifikimit të familjeve nga Administratorët Shoqërorë, plotësojnë kriteret për marrjen e kësaj ndihme.
2. Familjet përfituese sipas listës bashkëngjitur,dalë nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike.

Drejtori i Shërbimeve Sociale

Rexhep Shaka

Pergj / Sekt.Nd.Ekonomike

Selime Ozani

**KRYETARI I BASHKISË  
MARIGLEN DISHA**

## RELACION

### **Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6%**

Përfitimi i ndihmës ekonomike bëhet në bazë të aplikimeve në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike nga data 1 deri 10 të çdo muaji. Në fund të çdo muaji nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social del vendimi, i cili në bazë të formules se unifikuar në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike, dalin familjet jo përfituese për shkak të mos plotësimit të pikëve.

Administratorët Shoqërorë të ndihmës ekonomike në bazë të ligjit bejnë verifikimin e familjeve jo përfituese në sistem për arsye të mos plotësimit të pikëve, dhe në bazë të vlerësimit social ekonomik të çdo familje bejnë rekomandimin në sistem për përfitimin e ndihmës ekonomike nga fondi 6%

Mbështetur në vendimin nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike kreu IV, vendimit nr.956 datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike", familjet përfituese nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%, rekomandohet nga vetë sistemi elektronik ku përveç ndihmës ekonomike në masën e përfitimit përfshihet edhe kompesimi i energjisë elektrike.

Në këtë Projekt Vendim janë paraqitur familjet përfituese për periudhën e muajit Tetor 2023 ku janë gjithsej 89 familje me fond 378,703 leke të ndarë përkatësisht: vlera 6% është 318,167 leke dhe vlera 60,536 leke është kompesim i energjisë elektrike.

#### **Njesitë Administrative:**


1. Njësia Administrative Qytet	47 Familje me fond	200,145 lekë
2. Njësia Administrative Hotolisht	14 Familje me fond	66,169 lekë
3. Njësia Administrative Polis	15 Familje me fond	57,602 lekë
4. Njësia Administrative Qendër	10 Familje me fond	39,224 lekë
5. Njësia Administrative Orenjë	3 Familje me fond	15,563 lekë

**Totali si Bashki 89 familje me fond 378,703 lekë**

Pergj /Sekt Nd.Ekonomike

Selime Ozuni





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

Gjeneruar nga: Sistemi i menaxhimit te ndihmes ekonomike më: 21-11-2023 , 03:22 PM

Bashkia	Njësia administrative	Nr	Emri i Aplikantit	NID	Vlera e përloqaritur	Kompensimi i Energjisë	Totali	Numri
					për fondin 6%			anëtarëve
Librazhd	Hotolisht	1	Aishe Arif Skura	G75318018J	3,703	1,288	4,991	2
		2	Avni Reshit Stafa	H20620213J	2,178	1,288	3,466	1
		3	Beqir Xhaferr Duka	G40305033U	2,178	1,288	3,466	3
		4	Fatbardha Dalip Kurti	G45320047G	2,178	1,288	3,466	1
		5	Jonuz Shahin Çota	G30206013H	3,703	1,288	4,991	3
		6	Manushaqe Qerim Çuka	G95804048A	3,703	1,288	4,991	4
		7	Muhamet Qazim Gega	G50501112O	3,703	1,288	4,991	2
		8	Nazmi Hasis Sina	G10420107U	3,703	1,288	4,991	2
		9	Qani Rexhep Zharri	G60402066J	5,227	1,288	6,515	4
		10	Qemal Riza Alliu	F90401113W	3,703	1,288	4,991	2
		11	Vero Elmaz Duka	G30212084C	3,703	1,288	4,991	2
		12	Xhemile Fehta Menalla	G95208071N	2,178	1,288	3,466	1
		13	Ymer Xhaferr Kala	G31020023L	4,574	1,288	5,862	4

		14	Zylfije Zyber Qyra	G55926042P	3,703	1,288	4,991	2
		14	<b>Total Njësia Administrative: Hotolisht</b>		48,137	18,032	66,169	33
Librazhd		1	Agron Hasan Hajdari	H00325029U	2,178		2,178	1
		2	Ahmet Islam Balla	G00201028D	3,703	1,288	4,991	2
		3	Aishe Sulejman Belba	G15213055C	3,146	1,288	4,434	1
		4	Ardi Osman Elezi	I61115008U	2,178	1,288	3,466	1
		5	Artur Musa Agastra	G10101021O	2,178	1,288	3,466	1
		6	Bukurie Seit Vërçari	H65321017Q	3,703		3,703	2
		7	Bukurije Xhevit Alla	G36105057C	2,178	1,288	3,466	2
		8	Deje Muharem Coxa	G45915009K	2,178	1,288	3,466	1
		9	Dritan Nazmi Brahja	I30216010M	2,178		2,178	1
		10	Eliverda Andon Balliu	I26124018J	7,920		7,920	3
		11	Elona Shefki Mojsja	I25525024W	5,940		5,940	2
		12	Endrit Hamit Mojsja	I11221017B	3,703		3,703	2
		13	Enver Hajri Hoxha	G20205088V	3,703	1,288	4,991	2
		14	Farije Sefedin Topi	G05328025 M	3,146		3,146	1
		15	Fatmir Xhemal Allko	G50711141O	2,178		2,178	1
		16	Fatmira Beqir Hysa	H70522017S	2,178		2,178	1
		17	Fatmira Hysen Gjorga	G15420041E	3,146		3,146	1
		18	Gentila Qamil Doda	I85228018N	5,940		5,940	2
		19	Grigori Faik Cani	I30108161S	12,672		12,672	5
		20	Hekurane Xhaferr Jugu	I65909010L	7,920		7,920	3
		21	Hyrije Adem Çota	E55210169R	3,146	1,288	4,434	1
		22	Irena Agim Balazi	I65427026D	1,980		1,980	2

		23	Iva Zini Shehu	J25701027C	5,881		5,881	5
		24	Jonida Faik Hunçi	I75522027N	5,940	1,288	7,228	2
		25	Kujtim Hasan Buzra	F90826008C	3,703		3,703	2
		26	Leonard Enver Brasha	J60806018C	2,178		2,178	1
		27	Luljeta Hashim Zajaku	H35210033G	1,525		1,525	1
		28	Lulzime Nebi Roçi	J55223019R	5,940		5,940	3
		29	Manushaqe Ferit Shkurti	H15712010O	2,178		2,178	1
		30	Mereme Sali Murashi	G15210030C	3,146	1,288	4,434	1
		31	Mirjana Abdulla Çollaku	G76014110Q	2,178	1,288	3,466	1
		32	Olsi Nazmi Dosku	H50108018L	2,178		2,178	1
		33	Qamil Selman Ferra	F80501032B	3,146		3,146	1
		34	Qanije Refat Brasha	F95520031H	3,146		3,146	1
		35	Rajmonda Luan Zylali	I26014010H	5,940	1,288	7,228	2
		36	Ramadan Sali Seferi	G00622009 W	2,178	1,288	3,466	1
		37	Ryzhdie Telha Gançi	E75510159P	3,146		3,146	1
		38	Sabije Livan Zyka	F66018008Q	5,720	1,288	7,008	1
		39	Sherife Hamit Muzhaqi	E45319020V	3,146		3,146	1
		40	Shyqyrie Belul Blloshmi	G65107079J	5,940	1,288	7,228	2
		41	Shyqyrije Qazim Shpata	D66211004 W	3,146		3,146	1
		42	Skenderie Petrit Xhabli	J15522025P	5,940		5,940	2
		43	Sote Ismail Çota	G25427005V	3,146		3,146	1
		44	Tahire Qamil Balla	G35812017F	3,146	1,288	4,434	1
		45	Vule Kadri Topi	F75710021A	3,146		3,146	1
		46	Xhemile Skender Omeri	E65308028J	3,146		3,146	1
		47	Xhevahire Haziz Biçaku	G45120093D	2,178	1,288	3,466	1

		47	<b>Total Njësia Administrative: Librazhd</b>		178,249	21,896	200,145	74
	Orenje	1	Besnik Belul Hida	G70626072T	3,703	1,288	4,991	2
		2	Enver Mexhit Kaca	F80502085T	6,138	1,288	7,426	3
		3	Kadrije Riza Kaca	E85608004U	3,146		3,146	1
		3	<b>Total Njësia Administrative: Orenje</b>		12,987	2,576	15,563	6
	Polis	1	Astrit Shefqet Cura	H30624055Q	3,703		3,703	2
		2	Bejaze Fejzulla Stërmuğu	G15408018C	3,146	-	3,146	1
		3	Faik Ismail Bufi	G60327051P	2,178	1,288	3,466	2
		4	Feride Ali Çota	E25406031S	3,146		3,146	1
		5	Hasime Xhaferr Murati	G65520118H	2,178	1,288	3,466	1
		6	Hava Hamit Hasani	G65823039B	2,178	1,288	3,466	1
		7	Imer Sali Ballolli	G30520374Q	3,703		3,703	2
		8	Kasem Halil Hasani	F90422061C	3,703	1,288	4,991	2
		9	Lule Hamit Alimeta	H15312031B	2,178	1,288	3,466	1
		10	Mereme Imer Bufi	G05510159K	3,146		3,146	1
		11	Naim Ismail Qoshku	H00711051L	2,178	-	2,178	1
		12	Shaban Haxhi Cekani	G40316069G	3,703	1,288	4,991	2
		13	Shyqyri Seit Alimeta	E20222004Q	4,752		4,752	2
		14	Xhemal Shaban Zharri	G00120136A	3,703	1,288	4,991	2
		15	Xhevahir Kadri Doçi	H40517080G	3,703	1,288	4,991	2
		15	<b>Total Njësia Administrative: Polis</b>		47,298	10,304	57,602	23
	Qender - LIBRAZH D	1	Elidjona Nevruz Stafa	J36104015C	5,940		5,940	2
		2	Fiqirete Ymer Rruplli	H85916021Q	2,178	1,288	3,466	1

		3	Isuf Jonuz Seferi	D60826014S	3,146	1,288	4,434	1
		4	Landi Kamer Rreshka	G60412065F	3,703	1,288	4,991	2
		5	Lavdiqe Xhemal Bajrami	G85502021C	2,178	1,288	3,466	1
		6	Mereme Mehmet Çerri	C75607020R	3,146		3,146	1
		7	Ramazan Isuf Brahja	G50203042H	3,703		3,703	2
		8	Sulejman Harun Çota	F20728042F	3,146	1,288	4,434	1
		9	Tefta Asllan Hoxha	G86222012E	2,178	1,288	3,466	1
		10	<b>Total Njësia Administrative: Qender - LIBRAZHD</b>		31,496	7,728	39,224	13
		10	Xhafer Seit Karaj	G60608068P	2,178		2,178	1
	<b>Total Bashkia: Librazhd</b>	<b>89</b>	-	-	<b><u>318,167</u></b>	<b><u>60,536</u></b>	<b><u>378,703</u></b>	<b><u>149</u></b>





P/vendimi N° 2



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA LIBRAZHË  
DREJTORIA E TAKSAVE VENDORE

P - V E N D I M

Nr \_\_\_\_ date \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2023

“PËR

RRITJE E PAKËSIM PLANI BUXHETOR TË VITIT 2023 TË TË ARDHURAVE VENDORE”

Në zbatim ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, 9632 date 30.10.2006 « Për Sitemin e Taksave Vendore » i ndryshuar , Ligji Nr 9920 , date 19.05.2008 » Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë « i ndryshuar, Ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” . Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.95 date 14.11.2022 “ Paketa Fiskale 2023 “ miratuar nga Prefekti i Qarkut me Nr 1358/1 date 05.12.2022 ,” është bërë rritja dhe pakësimi i të ardhurave , me propozim të Kryetarit të Bashkisë , Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ .2023 .

V E N D O S I:

- 1-Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave të Bashkisë Librazhd .
- 2- Të miratojë pakësimin e planit të të ardhurave të Bashkisë Librazhd .
- 3- Rritja e planit në vlerën 5,000,000 lekë (bashkëlidhur tabela )
- 4- Pakësimin e planit në vlerën 5,500,000 leke (bashkëlidhur tabela)
- 5 Ndjek zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Taksave Vendore, Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar.
- 6- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË

Mariglen DISHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
DREJTORIA E TAKSAVE VENDORE

**RELACION**  
**MBI SHITESË / PAKESIM PLANI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË**  
**PËR VITIN 2023**

**Të nderuar Këshilltarë :**

Parashikimi i të ardhurave të Bashkisë për vitin 2023 është bërë duke u bazuar në ligjet , udhëzimet VKM si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 95 ,datë 14.11.2022” Për miratimin e Paketës Fiskale 2023 dhe konfirmim akti nga Prefektura e Qarkut Elbasan .

Në planifikimin e saktë të të ardhurave jemi bazuar :

Në realizimin e të ardhurave faktike Janar – Dhjetor 2022 .

Në nivelin taksave dhe tarifave të përcaktuara sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak për cdo lloj aktiviteti .

Ky planifikim i të ardhurave të buxhetit të vitit 2023 synon sigurimin e burimeve financiare të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve .

Për vitin 2023 të ardhurat e Bashkisë janë planifikuar në vlerën 170,261 mijë leke , dhe me këtë projekt - vendim po paraqesim shtesë /pakësim plani sipas zërave në tabelën e mëposhtme .

**RRITJA /ULJE E PLANIFIKIMIT BUXHETOR PËR VITIN 2023 I TË ARDHURAVE .**

**Njësia e Vetëqeverisjes Vendore**

**2128001**

**/ 000 LEKE**

<b>Nr</b>	<b>Llojio i taksës e tarifës</b>	<b>Plani Viti 2023</b>	<b>Rritje / Ulje Plani 2023</b>
	<i>Te ardhura tatimore</i>		
	<i>Te ardhura nga taksat vendore</i>		
1	Tatim i thjeshtuar mbi biz e vogel	320	-500
2	Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale	10000	5000
3	Taksa mbi ndertesat	16000	
4	Takse mbi truallin	600	
5	Takse toke bujqesore	5450	
6	Taksa e kalim te drejtes se pronesisë	800	
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture ndertimet e reja	5100	-5000
8	Taksa e ndikimit ne infrastrukture legalizimet	3000	
9	Takse tabele	620	
10	Takse hoteli	170	

11	Taksa e regjistrimit pervitshem te automjeteve	14500	
12	Takse nga Renta	360	
13	Takse e perkohshme e ndikimit ne infrast.ne arsim2021 / permiresimi infrastruk. rrugore 2022	0	
		<b>56920</b>	
	<b>Te ardhura jo tatimore</b>		
	<b>Te ardhura nga tarifat vendore</b>		
1	Tarife pastrimi	19000	
2	Tarife ndricimi+Gjelbrimi	3500	
3	Tarife sherbimi ne varrezat publike	120	
4	Tarifa e sherbimit veterinar	200	
5	Tarife e tregut te organizuar	1200	
6	Tarifa leje per tregetim ambulator	60	
7	Tarife parkimi	1300	
8	Tarife per dhenie license e certificate transporti	500	
9	Tarife per leje te drejta , vertetime,informacione	750	
10	Tarife per zenien e hapsires publike	2150	
11	Tarife per librat e udhetimi te udhetareve brenda vendit	150	
12	Tarifa per autorizime ushtrim aktiviteti, autorizime per karburantet.	2000	
13	Tarifa te tjera nga Urbanistika	1650	
14	Tarife per linjat ajrore dhe nentokesore	430	
15	Tarife per mbetjet inerte	210	
16	Tarifa për ndikimin ne mjedis	7000	
17	Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.	100	
18	Kamatvonesa	1500	
19	Detyrimi i prapambetur nga taksat	19000	
	<b>Shuma</b>	<b>60820</b>	
	<b>Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave</b>		
1	Tarifa ne Sektorin e Pyjeve	12700	
2	Tarifa ne Sektorin e Kullotave	350	
3	Tarifa nga shfrytezimi i materialit drusor nga subjektet	21500	
4	Nga shfrytezimi I druve te zjarrit nga fshataresia	5600	
5	Nga shfrytezimi I prodhimeve te dyta pyjore, te tjera .	300	
6	Te ardhura nga perdorimi vertetimeve te transportit kamate vonese dok. Ankandi rap teknik etj	620	

7	Te ardhura nga shitja e materialit drusor qe dalin nga rrallimet	200	
	<b>Shuma</b>	<b>41270</b>	
	<b>Te ardhura te tjera</b>		
1	Qera e shitje trualli	600	
2	Qera ndertese , qera ndertese nga privatizimet	370	
3	Pagesa e prinderve çerdhe	1400	
4	Pagesa e prinderve kopesht	5140	
5	Detyr.te prapamb.nga kopshtet çerdhe dhe qendra ditore	916	
6	Gjoha nga IMT ,dhe Policia Bashkiake	2250	
7	Te ardhura nga pullat e gjendjes civile 5 %	75	
8	Sponsorizime	0	
9	Tarife akte ligjore e administrative, shitje skrap etj	0	
	<b>Shuma</b>	<b>10751</b>	
	<b>TOTALI</b>	<b>169,761</b>	<b>-500</b>

Pra sic shihet nga tabela kemi shtesë dhe pakësim plani në zërin :

- Tatim i thjeshtuar mbi biznesin e vogël  
Ishte 820,000 lekë , bëhet 320, 000 lekë .
  - Taksa nga tatimi mbi të ardhurat personale  
Ishte 5 ,000,000 lekë, bëhet 10,000,000 lekë
  - Taksa e ndikimit në infrastrukturë ndërtimet e reja  
Ishte 10,100,000 lekë, bëhet 5,100,000 lekë .
- Totali shtesë 5 milion lekë dhe ulje plani 5 milion e pesëqind lekë .

**Buxheti total vjetor 2023**

Ishte 170,261,000 lekë

Bëhet 169,761,000 lekë .

Duke u nisur nga realizimi faktik për periudhën 10 mujore 2023 tatimi i thjeshtuar dhe tatimi mbi të ardhurat personale e shohim të arsyeshme të ndryshojmë planin vjetor 2023 pasi dhe informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mungon .

Për taksën e ndikimit në infrastrukturë kemi ulje të planit pasi sipas informacionit të Drejtorise se Zhvillimit Ekonomik dhe Territorit nuk ka aplikime për leje ndërtimi .

Në përfundim të këtij relacioni mendojmë se planifikimi i të ardhurave dhe realizimi i tyre gjatë vitit 2023 është faktor i rëndësishem për zhvillimin ekonomik dhe përmbushjen e funksioneve të Bashkise ndaj komunitetit dhe për një pasqyrim sa më korrekt të planifikimit drejt realizimit faktik të buxhetit vjetor .


Duke shpresuar në miratimin tuaj!

**DREJTORE E TAKSAVE VENDORE**

**Lindita SHULI**

Adresa : Sheshi "Gjorg Golemi"Librazhd,

www.bashkialibrazhd.gov.al info@bashkialibrazhd.gov.al







P/vendimi N° 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Librazhd më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2023

**P/VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_/11/2023

**PËR**

**MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT 2024-2026**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Ligjit nr. 9131/2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" i ndryshuar, Ligjit nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit shtetëror", Ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Këshilli i Bashkisë Librazhd,

**TË VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit të Integritetit 2024-2026 për Bashkinë Librazhd, i cili është pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi të gjitha drejtoritë përkatëse të Bashkisë Librazhd.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

**KRYETARI I BASHKISË**

**MARIGLEN DISHA**

## RELACION

Plan i Integritetit 2023-2026 është një dokument i brendshëm strategjik anti-korrupsion, i cili synon të kontribuojë në forcimin e integritetit institucional, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë, si dhe mundësimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

Planifikimi i integritetit është një proces shumë i rëndësishëm që lejon institucionet e qeverisjes vendore dhe qytetarët që ajo përfaqëson, të luftojnë sjelljet jo etike, jo-profesionale dhe korruptive në institucion. Ky Plan Integriteti është një dokument operacional që do të drejtojë veprimtarinë e Bashkisë Librazhd drejt zhvillimit të një administrate vendore të përgjegjshme, llogaridhënëse dhe transparente.

Hartimit i Planit të Integritetit në Bashkinë Librazhd u realizua përmes një procesi gjithëpërfshirës. Punonjësit e bashkisë dhe drejtuesit kontribuan në vlerësimin e riskut të integritetit dhe propozimin e masave për përmirësimin e integritetit dhe reduktimin apo eliminimin e risqeve të integritetit për procese apo funksione të veçanta në institucion.

Ky proces përfshiu analizën e risqeve të integritetit për proceset e punës në fushat funksionale të bashkisë: i) Fusha e menaxhimit financiar; ii) Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore; iii) Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit; iv) Fusha e shërbimeve publike; v) Fusha e administrimit dhe menaxhimit të pronave; vi) Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit; dhe vii) Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronike.

Objektivat kryesore të Planit të Integritetit të Bashkisë Librazhd janë:

1. Përmirësimi i kuadrit të brendshëm politik dhe rregullator në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, si dhe parimeve të etikës dhe standardet e sjelljes profesionale
2. Konsolidimi i burimeve njerëzore, strukturave anti-korrupsion dhe pozicioneve të punës në bashki, të lidhura me funksionimin e mekanizmave të integritetit në institucion
3. Përmirësimi i menaxhimit të riskut të integritetit për fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nëpërmjet miratimit të këtij akti, Bashkia Librazhd angazhon për ndjekjen dhe zbatimin e tij të gjitha drejtoritë përkatës përgjatë 2023-2026.

Konceptoi: Elona Koçi 



P/Vendimi N° 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
KËSHILLI BASHKIAK

## PROJEKTVENDIM

Nr. dt. . 11.2023

### PËR VLERSIMIN ME TITULLIN “ QYTETAR NDERI” Z.NAIM GJOSHI

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,Neni 54,germa m,Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më date .11.2023 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

#### VENDOSI:

1.Z.Naim Gjoshi të vlersohet me titullin “Qytetar Nderi” me motivacion:

“ Për kontribut të shquar në kultivimin,përpunimin e folklorit muzikor dhe këngën qytetare të Librazhdit”

2.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Arsimit dhe Kulturës .

3.Ky vendim hyn ne fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË**

**MARIGLEN DISHA**

Relacion mbi jetën dhe veprën artistike të z.Naim Gjoshi.

Z.Naim Gjoshi ka lindur me 14.08.1950 ne fshatin Seferan të Dumresë, qarku Elbasan. Ai ka mbaruar Akademinë e arteve në periudhën 1969-1973, ne degën e muzikës, si specialist kori, duke mbrojtur diplomën me Korin e Teatrit te Operas dhe Baletit në Tiranë.

Pas përfundimit të studimeve, për arsye biografike emërohet si pergjegjes muzike në Pallatin e Kulturës të qytetit të Burrelit, ku ka punuar deri në vitin 1990, duke mbledhur dhe përpunuar këngë folklorike matjane, mbi te cilat ndërtoi dhe kompozoi këngën qytetare matjane, aq të njohur edhe sot e kësaj dite. Po mbi intonacionin e këtyre këngëve folklorike z.Naim Gjoshi ndërtoi dhe kompozoi muzikën e valleve dhe melodive instrumentale matjane.

Një arritje e suksesshme e tij gjatë kesaj periudhe ishte bashkëpunimi me grupin “Na bashkoi kënga popullore”. Produkti muzikor i këtij bashkëpunimi pati nje jehonë te gjerë në mbarë trojet shqiptare.

Në vitin 1991 me deshirën e vet, z.Naim Gjoshi vjen të punojë në Librazhd si specialist muzike pranë Qendrës Kulturore të Librazhdit, sot Pallati i Kulturës “Sadi Halili”. Njohja me folklorin e Luginës Shkumbinit i dha tinguj dhe ritme të reja krijimtarisë muzikore te z.Naim Gjoshi, duke shpalosur vlera të panjohura më parë të folklorit gojor dhe muzikor të Luginës së Shkumbinit dhe mbarë trevave të Librazhdit.

Në bashkëpunim me Mjeshtrin e Madh Sadi Halili, z.Naim Gjoshi përpunoi shumë motive këngësh dhe vallesh të trevave të begata librazhdase, me të cilat arriti te realizojë katër koncerte recitale me këngëtarët Hatixhe Lushi, Mergita Kola, Liljana Stafa, Shkodran Tole dhe këngëtarë të njohur kosovarë. Gjithashtu me Mjeshtrin Sadi Halili dhe mbështetjen e pushtetit vendor ka realizuar me sukses 6 (gjashtë) edicione të Valles Dyshe, aktivitet ky gjithëpërshirës kombëtar e mbarëkombëtar.

Me permbyshjen e diktarës dhe hapjen e proceseve dekokratike krijimtarisë së Naim Gjosit ju çelën shtigje të reja. Njohja me këngëtarët kosovarë dhe trevave shqiptare të Maqedonisë e Malit te Zi bëri që këngët e tij të shtegtojnë në mbarë trevat shqiptare. Ishte koha kur falë punës së z.Naim Gjoshi Librazhdi u bë epiqendra e emetimit të këtyre këngëve. Qyteti ynë dhe shtëpia e z.Naim Gjoshi ishin vendqëndrimi i sigurt i këtyre këngëtarëve që nëpërmjet këngës se tij përhapnin mesazhe patriotike në mbarë botën shqipëtare.

Në bashkëpunim me këta këngëtarë (kosovarë, shqiptarë të Maqedonisë dhe të Malit te Zi) z.Naim Gjoshi ka relalizuar disa koncerte me këngët e tij, duke e shndrruar skenën e Librazhdit dhe mbarë qytetin tonë në një hapësirë të vërtetë kulrurorë mbarëkombëtare. Për t’u veçuar janë:

1.Koncert recital me këngëtarin Selami Kolonja (shtator 1994).

2.Koncert “Homazh për Kosovën”(1998), i pari në shkallë kombëtare e mbarëkombtare me këngëtarin Kosovar Ilir Shaqiri, ku pjesëmarrës ishin dhe aktorët e mëdhenj shqipëtar: Artisti i Popullit Kadri Roshi, Artisti i Popullit Reshat Arbana dhe Artistja e popullit Margarita Xhepa.

Ky concert u regjistrua i plote nga RTSH dhe u parapriu koncerteve të tjera “Homazh për Kosovën” që u realizuan më pas në mbarë trojet shqiptare. Gjithashtu me 3.05.2006 falë punës së z.Naim Gjoshi u arrit organizimi i koncertit recital me këngëtarët: Violeta Kukaj, Farush Azemi, Hysni Klinaku dhe këngëtarët e qytetit të Librazhdit Hatixhe Lushi dhe Liljana Stafa.

Kompozitori Naim Gjoshi gjatë periudhës 30-vjeçare në Librazhd ka patur bashkëpunim të ngushtë me rreth 40 këngëtarë të trevave shqiptare si: Ilir Shaqiri, Shkurte Feza, Selami Kolonja, Violeta Kuka , Miranda Hashani, Besjana Mehmeti, Shkodran Tolaj, Vëllezërit Dervishi etj. Këngët më të bukura të kompozitorit Naim Gjoshi të njohura për temën patriotike, por edhe të vlersuara në pikëpamjen estetike si: “Jam Evropë”, “Poçari”, “Udhët e Mia”, “Male o Ju Male”, “Erdhi dita e Pavarsis” etj., e kanë filluar udhëtimin e tyre për në zemrat e mbarë shqiptarëve nga studiuja e kompozitorit këtu në Librazhd, nga

qyteti ynë, nga Lugina jonë e Shkumbinit. Që këtu nga sofrë jonë e begatë qytetare dhe kulturore e filloi udhëtimin për në zemrat e shqiptarëve edhe kenga hit, himni i tifozave kuq e zi “Mora Fjalë” nëpërmjet secilës u arrit të njehsohet shenja patriotike e skuadrës kombëtare shqiptare me portretin e heroit Adem Jashari, duke i bashkuar shqiptarët nga do që janë, në një kor gjigand patriotik.

Edhe pas daljes në pension z.Naim Gjoshi, ka kontribuar në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Femijëve Librazhd për kultivimin e 9 këngëve të vjetra popullore me qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore nga të rinjtë dhe krijimin e modeleve të këngës qytetare të Librazhdit.

Për merita të shquara në krijimtarisë muzikore z.Naim Gjoshi është nderuar si më poshte:

- 1.Është dekoruar dy herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me medaljen “Naim Fshashëri klasi i III”.
- 2.Qytetar Nderi i Burrelit.
- 3.Qytetar Nderi i Belshit.
- 4.Nderi i Dumresë, Shoqata e Dumresë.
- 5.”Mirnjohje” nga Shoqata e Invalidëve të Luftës në Kosove.
- 6.”Mirnjohje” nga Shoqata Porozhan Kosovë
- 7.Çertifikatë nga Albanian Life Quality Union
- 8.”Mjeshtër i merituar “ akorduar nga Presidenti i Republikës së Kosovës z.Hashim Thaçi.

Skënder KARRIQI

Librazhd, më 24.11.2023

P/vendimi N° 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD  
KRYETARI

**P/V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_.11.2023

**MBI MIRATIMIN E KRYETARIT TË FSHATIT HOTOLISHT NJËSIA  
ADMINISTRATIVE HOTOLISHT BASHKIA LIBRAZHD**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës \_\_\_\_/11/2023, në mbështetje të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore, i ndryshuar nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1 shkronja(b) dhe neni 70 pika 1,2,3,4,5 neni 71:të

**VENDOSI:**

1. Të miratojë zgjedhjen e kryetarit të fshatit Hotolisht z. Mahmud Çota.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administrata e Bashkisë Librazhd.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË  
MARIGLEN DISHA**

P/Vendimi  
Nr. 7



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD  
KRYETARI

PROJEKT-VENDIM

NR\_\_\_\_, Date \_\_/\_\_/2023

**“PER MIRATIMIN E SISTEMIT TE PIKEZIMIT PER PROGRAMET E STREHIMIT”**

Bazuar ne Ligjin nr.22/2018, “Per strehimin social”,Ligji 139/2015 “Per veteqeverisjen Vendore”, VKM Nr.459, date 03.07.2019 “ Rregulla per administrimin e kerkesave te njesive te veteqeverisjes vendore per fonde nga buxheti i shtetit per subvencionimin e qirase ose uzufuktit, menyren e financimit te subvencionit, monitorimin dhe bashkepunimin ndermjet njesive te veteqeverisjes vendore dhe ministries pergjegjese per strehimin “Mbi miratimin e sistemit te pikezimit per programet e strehimit”,i propozoj Keshillit Bashkiak ne mbledhjen e dates \_\_/\_\_/2023

TE VENDOSI:

- I. Te miratoje sistemin e pikezimit per program e strehimit sipas tabelës Nr.1 bashkëlidhur këtij projektvendimi.
- II. Per zbatimin e ketij vendimi te ngarkohet Drejtoria e Planifikim dhe Zhvillim Territorit (Zyra e Sherbimeve dhe Strehimit) si dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Planifikimit Financiar.
- III. Vendimi hyn ne fuqi 10 (dhjete) dite pas shpalljes

**KRYETARI BASHKISE**

**Mariglen Disha**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZH  
KRYETARI

RELACION

**PER MIRATIMIN E SISTEMIT TE PIKEZIMIT PER PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TE QIRASE**

Bazuar ne Ligjin nr.22/2018, "Per strehimin social", Ligji 139/2015 "Per vetqeverisjen Vendore", VKM nr.384 dt. 12.06.2019 Per percaktimin e dokumentacionit sipas cdo programi social te strehimit dhe te afateve e te procedurave te miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore", VKM nr.362, date 29.5.2019 Kriteret e dhenies se subvencionit te qirase per kategorite qe gezojne perparesi ne subvencionimin e qirase ne tregun e lire, nepermjet buxhetit te shtetit, dhe menyren e llogaritjes se tij, u hartua sistemi i pikezimit per kete program.

Qellimi i hartimit te sistemit te pikezimit eshte te percaktoje kush jane kategorite qe duhet te perfitojne nga ky program. Njesia e vetqeverisjes vendore, ne hartimin e sistemit te pikezimit bazohet ne 4 kushte kryesore: kushtet e strehimit, kushtet familjare, kushtet sociale dhe kushtet ekonomike.

Sipas VKM nr.362, date 29.05.2019, pika 2.1 citon: *Radha e perparesise se ketyre kategorive prcaktohet ne perputhje me sistemin e pikezimit, qe miratohet me vendim te keshillit te njesise se vetqeverisjes vendore. Pesha e pikeve qe njesia e vetqeverisjes vendore i ngarkon kategorive te referuara ne piken 2, te ketij vendimi, varet nga perqindja qe ze secila kategori ndaj totalit, bazuar ne numrin e pergjithshem te aplikimeve te ketyre kategorive.*

Lidhur me kushtet e strehimit, perparesi i eshte dhene familjeve qe nuk kane shtepi/banese ne pronesi si dhe familjeve qe banojne ne banesa ne rrezik shembje e nevojshme per te mbeshtetur familjet qe hasen ne veshtiresi emergjente. Ne vleresimin e kushteve familjare, me shume pike sipas sistemit te pikezimit marrin familjet nje prinderore qe kane ne ngarkim femije nen 18 vjec, ku perfshihen edhe vajzat nena. Nen gjykimin tone kjo kategori mbetet si nje hallke sensitive e shoqerise, ndoshta dhe per vete faktin se kushtet apo mundesite e suportit ekonomik jane te lidhura ngushte me stigmatizimin.

Sa i takon vleresimit te kushteve sociale, piket me te larta i marrin personat me aftesi te kufizuar per faktin se konsiderohen si persona te pa mundur per te siguruar te ardhurat jetike nga puna, dhe ne vleresimin e kushteve ekonomike perparesi marrin familjet me te ardhura te ulta qe do te thote se nuk arrijne te sigurojne mjaftueshem te ardhura per te perballuar ekonomikisht jetesen.

Ju mund te gjeni me te detajuar kriteret dhe sistemin e pikezimit ne pasqyren e meposhteme:

Tabela nr.1 Sistemi I pikezimit

	<b>KRITERET</b>	<b>Piket sipas sistemit te pikezimit</b>
<b>I</b>	<b>Kushtet e strehimit:</b>	<b>10</b>
	a. Nuk disponojne banese ne pronesi	<b>10</b>
	b. Banojne ne banesa ne rrezik shembje	<b>5</b>
	c. Banojne ne banesa te mbipopulluara sipas normave ne fuqi.	<b>5</b>
<b>II</b>	<b>Kushtet Familjare:</b>	<b>7</b>
	a. Familje nje prinderore qe kane ne ngarkim femije nen 18 vjec, ku perfshihen edhe vajzat nena	<b>5</b>
	b. Te moshuarit	<b>5</b>
	c. Familjet me me shume se 4 femije	<b>3</b>
	d. Bashkeshortet , mosha e pergjithshme e te cileve arrin deri ne 60 vjec.	
<b>III</b>	<b>Kushtet sociale</b>	<b>10</b>
	a. Personat me aftesi te kufizuar	<b>5</b>
	b. Familje te komunitetit egjiptian	<b>5</b>
	c. Invalidet e punes	<b>5</b>
	d. Viktimat e dhunes ne familje	<b>5</b>
	e. Viktimat e trafikimit/viktima te mundshme te trafikimit	<b>5</b>
<b>IV</b>	<b>Kushtet ekonomike:</b>	<b>10</b>
	a. Familje me te ardhura nen 80 % te te ardhurave mesatare	<b>7</b>
	b. Familjet me te ardhura 80- 100 % te te ardhurave mesatare	<b>3</b>
	c. Familje me te ardhura 100-120 % te te ardhurave mesatare	

Konc. Sektori I strehimit

P/Vendimi  
№ 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHË  
KËSHILLI BASHKIAK

## PROJEKTVENDIM

Nr. dt. . 11.2023

PER EMERTIMIN E SHKOLLES 9-VJECARE ZDRAJSH-QENDER "SHEJNAZE JUKA"

Mbeshtetur ne ligjin nr.139/2015,date 17.12.2015"Per veteqeverisjen Qeverisjes Vendore " te ndryshuar ,Neni 54, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me date .11.2023 dhe me propozim te Kryetarit te Bashkise Librazhd:

### VENDOSI:

- 1.Shkolla 9-vjeçare Zdrajsh-Qendër,Njesia Administrative Orenjë te emërtohet "Shejnaze Juka"sipas relacionit bashkëngjitur.
- 2.Ndjek zbatimin e ketij vendimi Kryetari i Bashkise,Drejtoria e Arsimit dhe Kultures,Zyra Vendore Arsimore Librazhd dhe Shkolla e Mesme e Bashkuar Orenje.
- 3.Ky vendim hyn ne fuqi 10(dhjete) dite pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISE**

~~MARIGLEN DISHA~~



Kabineti  
Sek. Këshillit

16.11.23

7245

DT 16.11.2023

ORGANIZATA E DËSHMORËVE TË ATDHEUT  
BASHKIA LIBRAZH D  
Nr. 70 prot.

Librazhd, më 13 nëntor 2023

### K Ë R K E S Ë

Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK PRANË BASHKISË L I B R A Z H D.

Lënda: Kërkesë për vendosjen e emrit të Heroinës së Popullit "Shejnaze Juka" Shkollës 9-vjeçare Zdrajshë-Qendër.

Këshilltarë e këshilltare të Bashkisë Librazhd,  
Ju urojmë suksese në punën tuaj!

Më 19 dhjetor 2023 mbushen 80 vjet nga rënia në luftë kundër pushtuesit në fshatin Zdrajshë të Heroinës së Popullit, Shejnaze Juka. Kërkojmë që Shkollës 9-vjeçare të fshatit Zdrajshë-Qendër, e cila ndodhet afër vendit ku ka rënë, t'i vendoset emri "Shkolla 9-vjeçare "Shejnaze Juka" Zdrajshë-Qendër."

Më poshtë po u njohim shkurtimisht me jetëshkrimin e Heroinës së Popullit", Shejnaze Juka.

Shejnazja indi në Shkodër më 15 gusht të vitit 1924, nga një familje e pasur, me tradita atdhetare. Nëna e saj ishte nga Elbasani. Mësimet e para i mori në vendlindje. Shejnazja shkoi në Itali, në Firence, për të vazhduar studimet, por i ndërpret pas okupimit të vendit nga fashistët italianë. Pastaj vazhdon studimet në Institutin Femëror "Donika Kastrioti" në Tiranë. Ishte edhe anëtare e organizatës së Rinisë Komuniste që nga themelimi i saj. Mori pjesë në disa demonstrata antifashiste. Veprimtarinë revolucionare e zhvilloi në Tiranë dhe më 1942 u hodh në ilegalitet për të punuar me rininë e qytetit të Elbasanit. Më 1 maj 1943, bashkë edhe me 100 normalistë nga Shkolla Normale e Elbasanit, u hodhën në luftë, duke u rrjeshtuar në çeta e batalione partizane. Lumja (ishte pseudonim i Shejnazes) u inkuadrua në Batalionin Partizan të Çermenikës. Ajo, me guxim, vendosmëri e trimëri, mori përsipër tri detyra të rëndësishme: vetë të ishte pjesëtare aktive e batalionit në frontin e luftës për çlirim, të mobilizonte popullin, veçanërisht rininë në luftë kundër pushtuesëve dhe t'u mësonte fëmijëve të Çermenikës shkrim e këndim. Të tria këto detyra, vajza shkodrane Shejnaze Juka edhe pse nuk i kishte mbushur të nëntëmbëdhjetat, i kreu me sukses.

Shejnazja u bë shumë shpejt e dashur për banorët. Pas luftimeve, u mësonte shkrim e këndim djemëve dhe vajzave të Orenjës.

Më 18 dhjetor 1943 në Orenjë, ku ishte dislokuar edhe Shtabi i Përgjithshëm e LANÇ-it, u përhap lajmi se forca të mëdha gjermano-tradhëtare do të sulmonin fshatin dhe do ta digjinin atë. Menjëherë, një pjesë e forcave të Batalionit të Çermenikës, ku bënte pjesë edhe Lumja, u vendosën në kodrën shkëmbore të Dërsisë, Zdrajshë, ndërsa forcat gjermane në Malin e Shkozës. Luftimet u zhvilluan shumë të ashpra. Armiku ishte më superior në numër, armatime. Pas shumë orë luftimesh të ashpra, më 19 dhjetor 1943, bie në fushën e betejës Lumja (Shejnazja) dhe tre elbasanllinitë: Bardhyl Popa, Fehmi Kotherja dhe Shefqet Tosku. Në qendër të fshatit, për të përkujtuar të rënë në këte betejë, është ngritur një lapidar.

Për veprimtarinë e saj në shërbim të Atdheut Shejnaze Juka është vlerësuar me titullin në të lartë, "Heroinë e Popullit."

Me respekt,

PËR ORGANIZATËN E DËSHMORËVE TË ATDHEUT PRANË BASHKISË LIBRAZH D

K R Y E T A R I

Ismet Muça



[Handwritten signature]

P/Vendimi  
№ 9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD

**P/VENDIM**

Nr. \_\_\_ dt. \_\_\_.11.2023

PER MIRATIMIN E PLANIT TE AKTIVITETEVE, KONSULTIMEVE DHE BUXHETIT TE KESHILLIT  
BASHKIAK LIBRAZHD PER VITIN 2024

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1 nenpika 1.1, germa b, neni 51 pika 3 ,neni 54 germa k, neni 55 pika 2, si dhe ne zbatimin te Rregullores se funksionimit dhe Organizimit te Keshillit Bashkiak ,mbeshtetur ne Propozimin e Kryetarit te Keshillit, Keshilli Bashkiak i mbledhur sot me date \_\_\_/11/2023.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë planin e aktiviteteve ,konsultimeve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak Librazhd per vitin 2024.
2. Ndjek zbatimin e ketij vendimi Sekretari I Keshillit Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) dite pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISE**

MARIGLEN DISHA

Keshilli Bashkiak i Librazhd  
BUXHETI VJETOR 2024

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Numri	Paga dhe sigurime mujore	Vlera vjetore	Shtemime
1	Shpenzime per konsultime (dediqur te plani vjetor i konsultimeve)	Buxheti, paketa fiskale, shifra dheje me qem e pronave, pritimi : komisionere te keshillit, rregulloret se keshilli, plani strategjik i zhvillimit te bashkes.		60,300	Vlera vjetore nga sheet 2-Plani i konsult. me shpenzime
2	Honorar per Keshillin (1/10 e pages se kryetarit)	21	12,500	3,150,000	Sipas ligjit 139/2015 per pagesen e Keshilltarëve
3	Kryetarit e strukturave komunitare	25	10,786	3,235,800	
4	Sekretari i Keshillit, page, sig. shoqetore	1	85,000	1,020,000	
5	Siqurime Shoqetore Sekretari, punedhenesi	1	14,195	170,340	
6	Kosto pajise Sekretari i Keshillit			150,000	
7	<b>Nentorial 1+2+3+4+5</b>			<b>7,786,440</b>	
8	Kosto trajtimit Sekretari i Keshillit (me bashkefinancim Keshilli Bashkiak me BF, Keshilli 10% - BF 90%) 1 trajtim	1	1,500	1,500	
9	Kosto trajtimit te komisionere (me bashkefinancim Keshilli Bashkiak me BF, Keshilli 10% - BF 90%) 21 anetare x 2 trajtime	20	1,500	30,000	
10	Udhetime e detyra Keshillaret, Sekretari			260,000	
11	Shpenzime per dhurata ceremoniale			30,000	
12	Fond te barabarte per aktivitetin perfaqesues te secilit Keshilltar (Fond perfaqesimi)			30,000	
13	Fond per aktivitet e Alances se Grave KB Lib			30,000	
14	Anetarism ne organizata profesionale (tarifa)			20,000	
15	Botime periodike (raporti vjetor i veprimtarise se keshillit, gazeta juridike e keshillit, fletpalosje)			150,000	
16	Botime te tjera: permblidje 4 vjecare e vendimeve te Keshillit			10,000	
17	Biletje ltrahsh, botimesh te interesit te Keshillit			10,000	
18	Biletje karta urumi per festat zyrtare			10,000	
19	Dergim me poste i dokumenteve, shkresave te keshillit dhe keshilltarëve			10,000	
20	Abonim ne revista e gazeta			10,000	
21	Abonim ne fletore zyrtare				
22	Shpenzime te pajparashkuara (kontingjence)			300,000	shpenzime te tjera (fond rezerve)
23	Kancelari per zyre			20,000	
24	Mirembajtje pajise kompjuterike			60,000	
25	Ekspertize (3 ne vit)			931,500	
26	<b>Shpenzime te mepërme per 1 vit</b>			<b>8,717,940</b>	
<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>					



Kostot totale per Sekretarin Keshillit Bashkiak Librazhd 2024

Shpenzime per Paisje				scope	qumimi/scope	total
		Kompiuter				
		Printer/Scanner				
		Tyreze+Kartige				
Media		Mirembajtje sistemi regjistrimit Audio + Video	1	60,000	60,000	
		Web page	1	90,000	90,000	
Per vizita ne kercen		Automjet				
<b>Net-total 1</b>						<b>150,000</b>

Shpenzime Operative						
Shpenzime operative mujore	Pagat	Paga Bruto Sekretari	12	85,000		1,020,000
		Sigurimet shpërqorë sekretari punedhënesi	12	14,195		170,340
		Paga Bruto Ndihmes Sekretari				0
		Energji elektrike, Uje, Internet, Telefon, Mirembajtje Web site, etj	12			0
		Kancelari		1	20,000	20,000
		Logjistika	Karburant			0
		Shofer			0	
		Total/Muaj				1,210,340
<b>Net-total 2</b>						<b>1,210,340</b>
<b>Kostot totale (Net-total 1+2)</b>						<b>1,360,340</b>

**Keshilli Bashkiak Librazhd**  
**BUXHETI VJETOR 2024**

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Numri	Paga dhe sigurime mujore	Vlefia vjetore	Shenime
1	Shpenzime per konsultime (detajuar te plani vjetor i konsultimeve)	Busheti, paketa fiskale, ahnga dhenje me qera e pronave, miratimi i komisioneve te keshillit, rregulltores se keshillit, plani strategjik i zhvillimit te bashkise,		<b>60,300</b>	Vlera vjen nga sheet 2-Plani i konsult. me shpenzime
2	Honorare per Keshillin (1/10 e pages se kryetari)	21	12,500	3,150,000	Sipas ligjit 139/2015 per pagesen e keshilltarëve
3	Kryetari e strukturave komunitare	25	10,786	3,235,800	
4	Sekretari i Keshillit, page, sig. shoqerore	1	85,000	1,020,000	
5	Siqurime Shoqerore Sekretari punedhenses	1	14,195	170,340	
6	Kosto pajise Sekretari i Keshillit			150,000	
7	<b>Nentotal 1+2+3+4+5</b>			<b>7,786,440</b>	
8	Kosto trajtimi Sekretari i Keshillit (me bashkefinancim Keshilli Bashkiak me BF, Keshilli 10% - BF 90%) 1 trajtim	1	1,500	1,500	
9	Kosto trajtimi te komisioneve (me bashkefinancim Keshilli Bashkiak me BF, Keshilli 10% - BF 90%) 21 aneture x 2 trajtime	20	1,500	30,000	
10	Udhetime e detyra Keshilltarët, Sekretari			260,000	
11	Shpenzime per dhurata ceremoniale			30,000	
12	Fond te barabarte per aktivitetin perfaqesues te secilit Keshilltar (fond perfaqesimi)			30,000	
13	Fond per aktivitet e Alences se Grave KB Lib			30,000	
14	Anetarsim ne organizata profesionale (tarifa)			20,000	
15	Botime periodike (raporti vjetor i veprimtarise se keshillit, gazeta juridike e keshillit, fletpalosje)			150,000	
16	Botime te tjera. permitedhje 4 vjecare e vendimeve te Keshillit			10,000	
17	Bleterje librash, botimesh te interesit te Keshillit			10,000	
18	Bleterje Karta urimi per festat zyrtare			10,000	
19	Dergim me poste i dokumenteve, shkrimesh te keshillit dhe keshilltarëve			10,000	
20	Abonim ne revista e gazeta			10,000	
21	Abonim ne Rietore zyrtare				
22	Shpenzime te pajparashikuara (kontigjence)			300,000	shpenzime te tjera (fond rezerv)
23	Kancelari per zyre			20,000	
24	Mirembajtje pajisje kompjuterike			60,000	
25	Ekspertize (3 ne vij)			931,500	
26	<b>Shpenzime te mepseme per 1 vit</b>			<b>8,717,940</b>	
<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>					

Cikli buxhettit Keshilli Bashkac Librazhd 2024

Nr.	Afajet	Aktivitetet	Pergjegjes
1	31 Dhjetor	Miratimi i kalendariit per pergatitjen e PBA-se dhe projektbuxhettit vjetor	Kryetari i njesise se geverisjes vendore
2	31 Janar	Hartimi i raportit me vleresime paraprake afatmese te te ardhurave	Njesia Pergjegjese per tatim taksave
3	Janar	Shqyrtimi dhe miratimi ne Keshilli i raportit per paraqitimin e te ardhurave	Keshilli i Bashkise
4	Mars	Pergatitja dhe miratimi ne keshillin bashkac i tavanave pergatitore per secilin program buxhetor	GMS & EMP
4	15 Mars	Miratimi ne Keshilli i tavanave pergatitore per secilin program buxhetor	Keshilli i Bashkise
5	Prill	Udhhezimi i brendshem per pergatitjen e PBA-se me tavanet buxhetore te miratuara per cdo program, manualin shpjegues, pasqyrat per plotesim nga EMP-ja per kerkesat buxhetore	GMS & EMP & Drejtorite/Departamentet perkatase
6	1-10 Maj	Plotesimi i kerkesave buxhetore te konsoliduara per cdo program dhe kerkesave shtese sipas programeve nga drejtuesit e EMP-ve	EMP-te & Drejtorite/Departamentet perkatase
7	15 Maj	Vleresimi dhe miratimi nga GMS-ja i kerkesave buxhetore te paraqitura nga drejtuesit e EMP-ve	GMS & EMP
8	31 Maj	Miratimi buxhettit faktik	Keshilli i Bashkise
9	1 Qershor	Hartimi i draft-dokumentit te PBA-se dhe dergimi ne MF (formatet e derguara nga MF-ja)	GMS & EMP & Kryetari i njesise
10	30 Qershor	Shqyrtimi i rekomandimeve per draft PBA-ne dhe pergatitja e opinionit ne lidhje me te. Draft PBA-ja shodhetur nga rekomandimi dhe vleresimi i tyre paraqiten ne keshillin e njesise per miratim	Kryetari i njesise & GMS
11	Qershor	Keshilli miraton projekt dokumentin e programit buxhetor afatmese	Keshilli i Bashkise
12	30 Qershor	Dergimi me shkrim dhe elektronikisht i PBA-se se miratuar nga keshilli ne MF.	Kryetari i njesise & GMS
13	5 Korrik	Publikimi i dokumentit te pare te PBA-se te miratuar	Kryetari i njesise & GMS
14	20 Korrik	Miratimi nga Keshilli i tavanave perfundimtare te shpenzimeve te programit buxhetor afatmese ne nivel programi	Keshilli i Bashkise
15	25 Korrik	Udhhezimi i brendshem i cili perrmban tavanet perfundimtare te shpenzimeve ne nivel programi per tre vite dhe afajet per pergatitjen e kerkesave te rishikuara te shpenzimeve te programit buxhetor afatmese	Kryetari i njesise & GMS
16	Gusht	Finalizimi te projektit te dokumentit te programit buxhetor afatmese te rishikuar dhe publikimi i tij	GMS & EMP
17	Gusht - Shtator	Degjuesat publike per PBA-ne	Kryetari i njesise & GMS
17	Shtator	Miratimi nga Keshilli i dokumentit te programit buxhetor afatmese te rishikuar	Keshilli i Bashkise
18	15 Shtator	Bashkia dergon ne Minfin dokumentin e programit buxhetor afatmese te rishikuar, te miratuar nga keshilli i njesise, se bashku me nje informacion mbi rekomandimet e dhena nga Minfin-ja gjate fazes se pare.	Kryetari i njesise & GMS
19	5 Tetor	Zhvillimi i seanceve te konsultimit dhe reflektimi i sugjerimeve ne dokumentin final te PBA-se	Kryetari i njesise & GMS & EMP
20	30 Nentor	Pergatitja e dokumentit final te PBA-se dhe projekt-buxhettit vjetor dhe paraqitja per shqyrtim dhe miratim ne keshill	Kryetari i njesise & GMS
21	Dhjetor	Zhvillimi nga Keshilli seanceve te konsultimitme publike per PBA dhe buxhetin vjetor	Keshilli i Bashkise
22	25 Dhjetor	Miratimi nga Keshilli i dokumentit te PBA-se perfundimtare dhe projekt-buxhettit vjetor	Keshilli i Bashkise
22	31 Dhjetor	Publikimi i dokumentit te PBA-se perfundimtare dhe projekt-buxhettit vjetor	Kryetari i njesise & GMS
23	Dhjetor	Miraton kalendarin e programit buxhetor afatmese dhe te buxhettit vjetor	Keshilli i Bashkise